



**Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh dhe stafi
të Universitetit Politeknik të Tiranës
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus +
në University of A Coruña (UDC), Spanjë**

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët dhe stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, në University of A Coruña (UDC).

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime.
- Shkëmbimin e stafit për mësimdhënie/trajnim.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi, në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës dhe/ose Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit. Të kenë përfunduar të paktën një vit akademik.
- Stafi për mësimdhënie, nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës dhe/ose Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.
- Stafi për trajnim, nga të gjitha njësitë e UPT - së.

Kohëzgjatja e bursave:

- Për studentët: 3 - 5 muaj, Semestri i II, Janar 2024-Qershor 2024.
- Për mësimdhënie/trajnim 5 +2 ditë, Semestri i II i vitit akademik 2023 - 2024

Numri total i studentëve: 3

Numri total i stafit për mësimdhënie/trajnim: 2

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze, ose spanjolle);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës;



Key Action 1
- Mobility for learners and staff -

- Plani i propozuar i lëvizshmërisë, “Staff Mobility for Teaching/Training, Mobility Agreement”.
- Të paktën një nivel B2 i gjuhës angleze ose spanjolle

Të gjithë aplikantët duhet të pajisen me siguracion shëndetësor, të vlefshëm për Spanjën për gjithë periudhën e qëndrimit.

Për stafin dhe studentët e doktoraturës, për t’u përzgjedhur, rekomandohet që paraprakisht të vendosin kontakte me një anëtar të Fakultetit në UDC, për plotësimin e lëndëve në learning/teaching apo training agreement, në adresën: iro@udc.es dhe për të marrë më pas një letër pranimi paraprake nga UDC, (pre-acceptance letter).

Pas dërgimit në UDC të listës së studentëve dhe stafit të përzgjedhur nga UPT, kandidatët do të kontaktohen nga UDC përmes postës elektronike, duke iu dërguar atyre udhëzime në lidhje me procedurën e aplikimit. I gjithë procesi i aplikimit do të bëhet përmes portalit të UDC (UDC pranon vetëm aplikime në internet, pa pasur nevojë për dokumente origjinale.)

Aplikantët duhet të marrin në konsideratë që do të pranohet vetëm aplikimi online. Ata mund të kontaktojnë zyrën e UDC nëse kanë ndonjë dyshim në lidhje me informacionin e kërkuar në formularin e aplikimit online, përpara se të klikojnë “submit” . Në çdo kohë, aplikantët mund të ruajnë pjesë të informacionit të futur në formularin e aplikimit dhe të paraqesin aplikacionin në internet vetëm kur janë të sigurt se të gjitha informacionet e dhëna janë të sakta. Pas pranimit të këtyre aplikacioneve në internet dhe pasi të kontrollohen se përmbushin kërkesat, kandidatët do të marrin një letër pranimi që konfirmon pranimin e tyre në mënyrë që të fillojnë procedurat e vizave.

*Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën, për studenët është të paktën B1. (Për stafin është B2.) Studentët janë gjithashtu të mirëpritur të zgjedhin kurse spanjisht, ku niveli minimal i gjuhës spanjolle është B1. Studentët duhet të plotësojnë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Mobility Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në University of A Coruña (UDC), Spanjë, lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” te seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore.

Për të shkarkuar formatin e “Learning Agreement”, për studentë, klikoni më poshtë:
[ANEKS 2 - Mobility-agreement-studies, student.pdf \(upt.al\)](#)

Për të shkarkuar formatin e “Staff Mobility for Teaching/Training, Mobility Agreement” klikoni te:
[Drejtorja e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](#) , aneks 3/4.

Për të parë listën e kurseve që ofron University of A Coruña (UDC), në anglisht, klikoni te:
Students` mobility: https://www.udc.es/en/ori/infestudantesextranxeiros/mobilidade_Erasmus/erasmus-ka107/

Staff - Teaching mobility:

https://www.udc.es/en/ori/infPersonalEntrante/PersonalDocente/Erasmus_KA107/?language=es

Staff - Training mobility:

https://www.udc.es/en/ori/infPersonalEntrante/PersonalAdministrativo/Erasmus_KA107/?language=en

Afati për aplikim: Deri më 10 nëntor 2023, ora 12.00



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Key Action 1
- Mobility for learners and staff -



Aplikimi kryhet në Drejtorinë e Komunikimit dhe Koordinimit.

Për informacione shtesë, në lidhje me procesin e aplikimit, mund të kontaktoni në email:
abeqo@upt.al , rkodra@upt.al